



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZL.Anr.284/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Arsim Hamzaj - kryesues, Kymete Kicaj dhe Skender Çoçaj- anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Besir Sola, kandidat për anëtar të kuvendit komunal të Komunës së Mamushës, nga Subjekti Politik Kosova Demokratik Turk Partisi (KDTP), të paraqitur kundër Qendrës Komunale të Numërimit (QKN), për shkak të parregullsive gjatë numërimit për Zgjedhjet Lokale, të mbajtura më datë 12 Tetor 2025, në seancën e panelit të mbajtur me 22.10.2025, merr këtë:

V E N D I M

HEDHET e palejuar (pasafatshme) ankesa ZL.Anr.284/2025, datë 20.10.2025, e parashtruar nga Besir Sola, kandidat për anëtar të kuvendit komunal në Komunën e Mamushës, nga Subjekti Politik Kosova Demokratik Turk Partisi (KDTP), të paraqitur kundër Qendrës Komunale të Numërimit (QKN), për shkak të parregullsive gjatë numërimit të votave për Zgjedhjet Lokale, të mbajtura më datë 12 Tetor 2025.

A r s y e t i m

Me datën 20.10.2025, PZAP-i ka pranuar ankesën e Besir Sola, kandidat për anëtar të kuvendit komunal në Komunën e Mamushës, nga Subjekti Politik Kosova Demokratik Turk Partisi (KDTP), me të cilën pretendon se që nga fillimi deri tek përfundimi i numërimit të votave në QKN, ka vërejtur se ka pasur parregullsi, sepse ditën e dytë të numërimit të votave në QKN, KKZ në Mamushë ka marr vendim që asnjë vëzhgues nuk do të merr pjesë në numërimin e votave në QKN. Më tej në ankesë theksohet se për shkak të vendimit të KKZ-së, për ndalimin e pjesëmarrjes në vëzhgimin e numërimit në QKN, nuk ka mundur të raportoj parregullësit dhe të bashkangjes deklaratat e vëzhguesve si dëshmi. Kërkon që të bëhet rinumërimi në vendvotimet 3201/5 dhe 3201/03.

Në përgjigjen në ankesë të Komisionin Qendror të Zgjedhjeve – KQZ, sqaron se në përputhje me Rregullën Zgjedhore Nr. 16/2024 për Qendrat Komunale të Numërimit, konkretisht me nenet 6, 8 dhe 9, përcaktohet se në hapësirat e QKN-së lejohen të hyjnë vetëm

stafi i autorizuar i KQZ-së dhe i QKN-së, anëtarët e PZAP-së gjatë ushtrimit të detyrave zyrtare, dhe vëzhguesit e akredituar nga KQZ, të cilët janë pajisur paraprakisht me dokumenti e akreditimit zyrtar të vlefshëm për QKN.

Kandidati në fjalë, në momentin e pretenduar, nuk ka paraqitur asnjë dokument akreditimi zyrtar të lëshuar nga KQZ që e identifikon si vëzhgues të akredituar për hapësirat e Qendrës Komunale të Numërimit në Mamushë,

Për këtë arsye, dhe në përputhje me dispozitat e lartpërmendura, nuk i është lejuar hyrja brenda hapësirës së siguruar të QKN-së, ku zhvillohet procesi teknik i numërimit, verifikimit dhe regjistrimit të formularëve të rezultateve.

KKZ në Mamushë nuk ka nxjerrë asnjë vendim të vegantë lidhur me pretendimet e ngritura por ka vepruar në përputhje të plotë me rregullat e KQZ-së, duke respektuar kërkesat e sigurisë dhe integritetit të procesit të numërimit,

Është e rëndësishme të theksohet se nuk ka pasur asnjë pengesë për subjektet politike të akredituara që kanë poseduar dokumente të vlefshme nga KQZ për vëzhgim të procesit, dhe asnjë subjekt tjetër nuk ka raportuar trajtim të ngjashëm apo diskriminues,

Në përfundim, Qendra Komunale e Numërimit në Mamushë ka vepruar në përputhje me Rregullën Zgjedhore Nr.16/2024 dhe me udhëzimet operative të KQZ-së, ndërsa pretendimi i kandidatit nuk mbështetet në ndonjë shkelje apo veprim të kundërligjshëm të QKN-se,”

KQZ, pas shqyrtimit të ankesës dhe pretendimeve të palës ankuese në lidhje me kërkesën e juaj jep sqarimet/ përgjigjet si më poshtë: Bazuar në nenin 101 të Ligjit Nr. 08/ L-228, Rregulloren Zgjedhore Nr.16/2024, Qendrat Komunale të Numërimit (QKN), Procedura e Veprimit në Qendrën Komunale të Numërimit për Zgjedhjet Lokale 2025, e miratuar më 01.10.2025, Nr.01/2601/2025, përcaktohet procedura e detajuar lidhur me procesin e numërimit në QKN.

Rezultatet preliminare nga vendvotimet mund të korrigjohen në Qendrën Komunale të Numërimit, në përputhje me paragrafin 3 të nenit 14 të Rregullores Zgjedhore Nr. 16/2024 për Qendrat Komunale të Numërimit (QKN).

Rezultatet përfundimtare të procesit zgjedhore shpallen nga KQZ-ja pas përfundimit të numërimit të të gjitha fletëvotimeve nga vendvotimet e rregullta; fletëvotimeve nga votimi me kusht; fletëvotimet nga votimi i personave me nevoja të veganta; fletëvotimeve nga votimi jashtë Kosovës; vendosjes për ankesat eventuale nga PZAP dhe Gjykata Supreme dhe pas përfundimit të të gjitha procedurave në QNR, ku rezultati i publikuar është i ankimueshëm nga subjekte politike dhe kandidatët të cilët kanë pretendime në raport me numërimin e votave të tyre,

Pra, në momentin e publikimit të rezultateve përfundimtare nga KQZ-ja, palët e pakënaqura në pajtim me nenin 105 të LPZ, pala mund të ushtrojnë ankesë në afatin brenda dyzet e tetë (48) orëve në PZAP.

Në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP, gjatë shqyrtimit të ankesës është vërejtur se palët ankuese, nuk ka bashkëngjitur prova të mjaftueshme që do të mund të dëshmonin apo mbështesnin pretendimet e saj të paraqitura në ankesë.

Gjithashtu, ju njoftojmë se i gjithë materiali zgjedhor duke përfshirë edhe kamerat e sigurisë, pas përfundimit të gjithë procesit të punës së QKN i njëjti material zgjedhor dorëzohet nga QNR në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve -QNR, dhe të njëjtat mund të verifikohen dhe hetohen nga PZAP dhe organet drejtësisë.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës - PZAP, pas shqyrtimit të ankesës dhe shkresave të lëndës konstaton se:

- *Ankesat janë të palejuara (pasafatshme).*

Paneli, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore ka gjetur se ankesa e parashtruar nga Besir Sola, kandidat për anëtar të kuvendit komunal në Komunën e Mamushës, nga Subjekti Politik Kosova Demokratik Turk Partisi (KDTP), me të cilën ka pretenduar se që nga fillimi deri tek përfundimi i numërimit të votave në QKN, ka vërejtur se ka pasur parregullsi, sepse ditën e dytë të numërimit të votave në QKN, KKZ në Mamushë ka marr vendim që asnjë vëzhgues nuk do të merr pjesë në numërimin e votave në QKN., është e parashtruar pas afatit të përcaktuar ligjor.

Me dispozitën e nenit 105 paragrafi 1, në mënyrë decitive parashihet se *"Ankesat lidhur me administrimin e numërimit në QKN dhe QNR, dorëzohen me shkrim pranë PZAP-së brenda dyzet e tetë (48) orëve nga ndodhja e shkeljes së supozuar, " të Ligjit Nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës.*

Me dispozitën e nenit 9 paragrafi 5 të Rregullores Nr. 01/2025 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosijes së Ankesave të PZAP-it, parashihet që *" Personi mund të paraqes ankesë në PZAP, brenda dyzet e tetë (48) orëve për shkeljet e pretenduara",* ndërsa nën paragrafi 5.16. parashihet që *"Për shkeljet e pretenduara gjatë procesit të administrimit dhe numërimit në QKN dhe QNR".*

Në rastin konkret Paneli vlerëson se parashtruesi i ankesës ka dorëzuar ankesën në PZAP me datë 20.10.2025, ku ka pretenduar se që nga fillimi deri tek përfundimi i numërimit të votave në QKN, ka vërejtur se ka pasur parregullsi, sepse ditën e dytë të numërimit të votave në QKN, KKZ në Mamushë ka marr vendim që asnjë vëzhgues nuk do të merr pjesë në numërimin e votave në QKN, e po ashtu edhe nga përgjigja e KQZ është vërtetuar se aktiviteti i QKN-së në Komunën e Mamushës, *është përmbyllur me datën 14.10.2025,* me çka vërtetohet se ankesa e ankuesit nuk është paraqitur brenda afatit ligjor siç parashihet me nenin 105, paragrafi 1 të Ligjit

për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, andaj dhe e njëjta u deshtë që të hedhet si e palejuar (pasafatshme).

Paneli pas analizimit të shkresave të lëndë ka gjetur se ankesa është parashtruar pas afatit ligjor për paraqitjen e ankesës, sipas nenit 105, paragrafi 1 LZP-së, dhe nenit 9, paragrafi 5 nën paragrafi 5.16, i Rregullores Nr.01/2025 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave të PZAP-it, afati për dorëzimin e ankesës është brenda dyzet e tetë (48) orëve nga ndodhja e shkeljes së supozuar, ndërsa ankesa është dorëzuar në PZAP më datë 20.10.2025, ndërsa parregullsia për të cilin pretendon pala ankuese është bërë gjatë numërimit të QKN, i cili ka përfunduar më datë 14.10.2025, që do të thotë se ankesa është dorëzuar pas afatit të paraparë ligjor.

Andaj, nga arsyet e theksuara më lartë e në kuptim të nenit 105 paragraf 1 i LZP-së, dhe nenit 9 paragrafi 5 nën paragrafi 5.16 dhe neni 13, paragrafi 3, nën paragrafi 3.2 të Rregullës 01/2025, për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA

ZL.Anr.284/2025, datë 22.10.2025

Kryesues i Panelit
Arsim Hamzaj



KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.